



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
**Nr.01-060/01-4470/26 datë: 24.02.2026**



**Npi – 01/41 datë: 05.03.2026**

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), dhe neni 58 shkronja (j) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenit 45.4 dhe nenin 46.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Si dhe mbi bazën e prezentimit në Kuvend të Raportit vjetor financiar të Komunës së Shtimes për vitin 2025 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa Nr.11/06 të datës 26.01.2026, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më: 05.03.2026, miratoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR BUXHETOR TË KOMUNËS SË SHTIMES  
PËR VITIN 2025**

**I**

**Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e parë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 05.03.2026, me shumicën e votave miratoi, Raportin Vjetor Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2025.**

**II**

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Rrahman Jakupi